



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

Legjislatura III  
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit  
P-93  
Prishtinë, më 23 shkurt 2010, në orën 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

**PROCESVERBAL**

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 23 SHKURT 2010

**Në mbledhje morën pjesë:** Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Sabri Hamiti, Eqrem Kryeziu, Ibrahim Gashi, Naim Maloku, Nexhat Daci, Sllobodan Petroviq dhe Etem Arifi, anëtarë të Kryesisë;

Nga grupet parlamentare: Ramë Buja, Ibrahim Makolli, Lulzim Zeneli dhe Numan Baliq;

**Në mbledhje ishin të pranishëm:**

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi, Eshref Vishi dhe Skënder Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Selman Ymeri dhe Sherif Konjufca;

Nga Presidenca: Lumnije Murati,

Nga NDI: Shefki Kastrati,

Nga OSBE: Florjana Shala,

Nga ICO: Blerta Bejtullahu, Siv Katrina Leirtrae dhe Trim Kabashi.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari konstatoi se në mbledhjen marrin pjesë tetë anëtarë të Kryesisë dhe katër kryetarë të grupeve parlamentare dhe hapi punimet e mbledhjes së sotme.

Ai i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

Kryesia i zhvilloi punimet me këtë

### **R e n d i t e:**

1. Debat, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të LDD-së, për zbatimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe për praninë e strukturave të pushtetit të Serbisë në territorin e Republikës së Kosovës,
2. Kërkesa e Komisionit të Pavarur për Media për emërimin e një anëtari në Këshillin e Komisionit të Pavarur për Media,
3. Kërkesat për lejimin e udhëtimeve zyrtare jashtë vendit.

### **1. Debat, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të LDD-së, për zbatimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe për praninë e strukturave të pushtetit të Serbisë në territorin e Republikës së Kosovës**

**Kryesia**, pasi diskutuan të gjithë anëtarët e saj dhe kryetarët e grupeve parlamentare lidhur me kërkesën e cekur më lart, **vendosi** që Kuvendi të mbajë seancë më 4 mars 2010, me këtë rend dite:

Debat, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të LDD-së, për zbatimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe për praninë e strukturave të pushtetit të Serbisë në territorin e Republikës së Kosovës.

### **2. Kërkesa e Komisionit të Pavarur për Media për emërimin e një anëtari në Këshillin e Komisionit të Pavarur për Media**

**Kryesia**, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, nxori këtë:

### **P Ë R F U N D I M**

1. Kërkohet nga grupet parlamentare që të propozojnë një anëtar në Këshillin e Komisionit të Pavarur për Media, në pajtim me procedurat e miratuara nga

Kuvendi.

2. Propozimet sipas pikës një (1) të këtij përfundimi duhet t'i dërgohen Kryesisë së Kuvendit deri më 03 mars 2010.

### **3. Shqyrtimi i kërkesës së anëtarit të Kryesisë, Slobodan Petroviq, për lejimin e udhëtimit zyrtar në Parlamentin Evropian**

**Kryesia**, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë:

#### **V E N D I M**

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i anëtarit të Kryesisë së Kuvendit, Slobodan Petroviq, në Parlamentin Evropian, prej 01 – 03 mars 2010.
2. Shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit për të lartpërmendurin, sipas paragrafit një (1) të këtij vendimi i mbulon organizatori, ndërsa pjesa shtesë e mëditjeve përballohen nga buxheti i Kuvendit.

### **4. Shqyrtimi i ftesës së Parlamentit Evropian për pjesëmarrje të delegacionit të Kuvendit të Republikës së Kosovës në punimet e Seminarit, me temën: “Kompetencat buxhetore të Parlamentit”**

**Kryesia**, pasi shqyrtoi ftesën e cekur më lart, mori këtë:

#### **V E N D I M**

1. Lejohet udhëtimi i delegacionit të Kuvendit në përbërje prej katër deputetësh dhe dy zyrtarësh të administratës së Kuvendit, në Seminarin e organizuar nga Parlamenti Evropian, me temën: “Kompetencat buxhetore të Parlamentit”, në Bruksel, prej 22 - 25 mars 2010.
2. Shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit për të lartpërmendurit sipas paragrafit një (1) të këtij vendimi i mbulon organizatori, ndërsa pjesa shtesë e mëditjeve përballohet nga buxheti i Kuvendit.

**Kryetari** e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 12:25 minuta.

Kryetari i Kuvendit,  
**Jakup KRASNIQI**

---

Hartoi: Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale